PERIODIKU BANKAR

VËSHTRIM MBI SEKTORIN FINANCIAR TË KOSOVËS

KONFERENCA VJETORE E BANKAVE TË KOSOVËS

SHËRBIMET DIGJITALE BANKARE NË KOSOVË

31 TETOR 2016

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

TETOR 2016 Numër 34
Publikim i Shoqatës së Bankave të Kosovës

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

PERIODIKU BANKAR

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Banka Ekonomike

BKT
BANKA KOMBETARE TREGTARE

BPB

İŞBANK

NLB Banka

ProCredit Bank

Raiffeisen BANK

TEB
BNP PARIBAS JOINT VENTURE

ZiraatBank

PËRGATITUR NGA:

DR. SC. PETRIT BALIJA,
Kryeredaktor

KRESHNIK KOSUMI,
Redaktor

MIRANDA RUGOVAJ
Koordinatore

MITHAT SEJDIU
Dizajn

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

DATA E PUBLIKIMIT,
Dhjetor 2016

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Deklarata e autorësisë: Materiali në këtë publikim ka të drejta autoriale. Kopjimi apo përdorimi i një pjese apo i tërë publikimit pa leje apo pa shënuar burimin e informacionit mund të konsiderohet shkelje e ligjeve në fuqi.

Shoqata e Bankave të Kosovës; Lidhja e Pejes, Zona Industriale, Prishtinë; 10000, Republika e Kosoves;
+381 38 246 171; www.bankassoc-kos.com; contact@bankassoc-kos.com;

KONFERENCA VJETORE – SHËRBIMET DIGJITALE

PËRMBAJTJA

PJESA I

Shërbimet Digjitale të Industrisë bankare 1 - 3

PJESA II

Të dhëna statistikore mbi shërbimet digjitale bankare 4 - 6

PJESA III

Indikatorët kryesorë të industrisë bankare të paraqitura në numra dhe figura 7

- Struktura e aseteve 7-8
- Struktura e detyrimeve 8-10
- Të hyrat dhe shpenzimet 10-13
- Norma efektive e interesit në kredi 13
- Norma efektive e interesit në depozita 13 - 14
- Kreditë jo-performuese 14-15

PJESA IV

Lajme nga industria bankare dhe ekonomia 16-21

I.
SHËRBIMET DIGJITALE BANKARE NË KOSOVË

Një studim tregon se bankat e Kosovës kanë aplikuar praktikat më të mira ndërkombëtare për procesin e tyre të vazhdueshëm të digjitalizimit për të përmirësuar shumë shërbimet retail, duke rezultuar në qasje të lehtë, me kosto të lire, 24 orë në llogari, dhe duke i lejuar konsumatorët të kryejnë transaksione kudo që të kenë qasje në internet.

Studimi u shpalos në "Shërbimet Digjitale Bankare në Kosovë", konferencë kjo e organizuar nga Shoqata e Bankave të Kosovës (SHBK) në bashkëpunim me Fondin Evropian për Evropën Juglindore – Development Facility (EFSE DF). Studimi i inicuar nga SHBK dhe i sponzoruar nga EFSE DF, është punuar nga Qendra për Hulumtime Strategji e Sociale – STRAS së bashku me PHB Development. Në konferencë u paraqiten përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës dhe bankat komerciale, institucionet mikrofinanciare, organizatat jo-bankare dhe shoqatat e ndryshme të biznesit dhe industrisë.

Gjetjet e studimit mbi digjitalizimin e sektorit dhe efektet e tij shërbejnë si një kujtesë se si aplikimi i teknologjisë së informacionit në sistemin bankar krijon mundësi dhe avantazhe për bankat dhe klientët e tyre, banorët e Kosovës.

Në fjalën hyrëse z. Petrit Balija, drejtor ekzekutiv i ShBK-së theksoi se konferenca po mbahet pikërisht në Ditën Botërore të Kursimeve, ndërsa për herë të parë po hapet edhe një temë, e cila ka të bëjë me funksionimin e brendshëm të bankave dhe të relacioneve të tyre me klientët, si është digjitalizimi.

Zëvendësguvernatori i Bankës Qendrore , Fehmi Mehmeti theksoi se i tërë sistemi bankar në Kosovë vazhdon të jetë i qëndrueshëm, stabil dhe likuid.

Është inkurajuese rritja shumë e madhe kreditimit, që tregon për kyçje gjithnjë e më të madhe të bankave në ndihmë për zhvillimin ekonomik.

Ilir Aliu, Kryetar i Bordit të Drejtorëve të ShBK bëri një vështrim për situatën aktuale në sistemin financiar. Për të me rëndësi është rritja shumë e madhe e të gjithë treguesve, si depozitave, kreditimit, por edhe rënia e shpejtë e normave të interesit për kredi.

"Duhet thënë se edhe fitimi i madh që kanë bankat kanë shënuar, nuk është arritur në dëm të klientëve, por duke ulur kostot dhe shpenzimet e përgjithshme dhe duke rritur vëllimin e shërbimeve", thesoj z. Aliu.
Prezantuesit e tjerë i cili përbëhej nga një panel i ekspertëve, diskutuan për zhvillimet e fundit dhe paraqiten gjetjet e tjera nga studimi. Ibrahim Rexhepi, Drejtor Ekzekutiv i Qendrës për Hulumtime Strategjike dhe Sociale (STRAS), ishte moderatori i panelit, ndërsa panelistët tjerë ishin Robert Wright nga sektori bankar, Zëvendës Guvernatori i Bankës Qendrore të Kosovës, Fehmi Mehmeti, Zëvendës-Ministrja Besa Zogaj-Gashi nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, anëtarja e Bordit të ProCredit Bank Kosova, Eriola Bibolli, dhe Venera Hoxha përfaqësuese e Finance in Motion, këshilltare e EFSE DF.
Rexhepi paraqiti një pjesë të studimit që tregon se bankat e Kosovës janë duke ndjekur me sukses tendencat e zhvillimit në digjitalizim edhe pse kanë më pak përvojë se vendet e tjera. Kjo tendencë ishte e dukshme kryesisht në përmirësimin e shërbimeve bankare, të cilat janë të fokusuara në qasje të lehtë dhe të pakufizuar në llogaritë e klientëve.
"Të gjitha bankat janë angazhuar tashmë në digjitalizim dhe i ofrojnë klientëve shërbime bankare mobile përmes aplikacioneve mobile dhe teksteve bankare. Për të arritur këtë nivel, bankat kanë përgatitur të gjithë kuadrin ligjor dhe institucional, si dhe një nivel të lartë të monitorimit", shpjegoi Rexhepi.

Për të ilustruar këtë zhvillim, ai vuri në dukje se në Kosovë ka rreth 188,000 llogari aktive e-banking, -18 për qind më shumë se në vitin 2014 – përmes të cilave 2.3 milionë transaksione janë bërë. Kjo përfaqëson një qarkullim 5.7 miliardë Euro, e që krahasuar me një vit më parë, është 36.5 për qind më shumë.
Prej më shumë se një milion kartelave në treg, pothuajse 835,000 janë kartela debiti, në bazë të ShBK-së. Në vitin 2015, 16 milionë transaksione retail janë përfunduar; shumica ishin tërheqje nga ATM dhe pagesa përmes terminaleve POS.
Në panel diskutimi, Robert Wright, nënkryetar i Bordit të Drejtorëve të ShBK tha se fillimisht duhet

bërë pyetjen se a është Kosova gati për këto shërbime. Duhet të kalojnë disa vjet përderisa shoqëria tërësisht të pranoj shërbime digjitale, meqenëse është sfidë serioze.

“Digjitalizimi i shërbimeve bankare sjell ndryshime revolucionare. Unë mendoj se Kosova është e gatshme për këtë proces”, tha Wright.

Pastaj, Fehmi Mehmeti, zëvendës Guvernator i BQK-së dha përgjigjen për formimin e agjencisë nacionale për procesim , si edhe përkushtimit që ka BQK-ja për avancimin shërbimeve bankare.

“BQK-ja ka ndërmarrë iniciativën për themelimin e Agjencisë Nacionale për Procesim, e cila do të zvogëlonte koston e shërbimeve dhe do të shkurtonte koston e transaksioneve, përkatësisht të pagesave. Ne do të vazhdojmë edhe më tutje në këtë drejtim, meqenëse shumë shpejt do të kemi edhe tenderin për këtë”, tha z. Mehmeti.

Zëvendës-Ministrja Besa Zogaj-Gashi, nga MZHE theksoi përpjekjet që po bëhen nga Qeveria në zhvillimin e teknologjisë së informacionit, i cili ka ndikim të madh në promovimin e shërbimeve bankare.

“Ne kemi hartuar strategjinë për teknologjinë informative, por njëkohësisht kemi edhe programin qeverisës, i cili i kushton rëndësi të veçantë kësaj çështje. Kjo është me rëndësi, meqenëse bizneset janë të orientuara kah shfrytëzimi i saj, kemi popullsi të re, e cila gjithnjë e më shumë po aftësohet për tregje të avancuara, por njëkohësisht kemi shkallë të lartë të shtrirjes së internetit dhe numër të madh të përdoruesve të tij”, tha zëvendësministrja Zogaj-Gashi.

Ndërkohë, Venera Hoxha, përfaqësuese e Finance in Motion - këshilltare e EFSE DF nënvizoi arritjet në Kosovë krahasuar me vendet e rajonit.

“Krahasuar me vendet e rajonit, Kosova nuk është keq sa i përket sistemit bankar, mirëpo është larg vendeve të zhvilluara. Ndërkaq, edukimi apo përgatitja për digjitalizim duhet të filloj nga grup-moshat e reja. Meqenëse në Kosovë janë një milion përdorues të internetit, ndërsa kemi vetëm 200 mijë përdorues të e-bankingut, kjo tregon se sa ka hapësirë për zhvillimin e shërbimeve digjitale”, tha znj. Hoxha.”

Eriola Bibolli anëtare e Bordit të Drejtorëve të SHBK-së nga ProCredit Bank theksoj ndikimin që digjitalizimi i shërbimeve ka pasur në zhvillimin e përgjithshëm të bankave. Ajo vuri në dukje se zhvillimet teknologjike kanë nxitur bankat që të digjitalizojnë shërbimet e tyre. Kjo sjell përfitime ekonomike, siç është optimizimi i kostos dhe shërbime më efikase ndaj klientëve.

“Aktualisht Kosova plotëson të gjitha kushtet për shërbime digjitale me standarde të larta evropiane. Madje, digjitalizimi nuk ka prekur vetëm klientët, por edhe vet bankat, të cilat kanë bërë ndryshime në përputhje me këto kërkesa”, theksoj znj. Bibolli.

Gjatë diskutimit u parashtruan pyetje rreth përkujdesjes së bankave ndaj konsumatorëve, rreth të vërtetës për paratë virtuale dhe krimit kibernetik, lehtësitë dhe produktet bankare të destinuara për diasporën dhe nevojës që të institucionet qeveritare të pajisen me POS terminale, në mënyrë që aty të ketë mundësi për pagesa me kartelë.

II.
TË DHËNA STATISTIKORE MBI SHËRBIMET DIGJITALE BANKARE



Fig. 1 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

TRANSAKSIONET ME E-BANKING				
Llogaritë, transaksionet dhe vlera	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**
Numri i llogarive	97,039	131,365	157,761	187,297
Numri i transaksioneve	625,762	1,056,655	1,579,388	2,311,564
Vlera e transaksioneve (mil euro)	1,499.00	2,671.00	4,220.00	5,746.00
(Burimi:BQK- Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash- dhjetor 2015)				

Tab. 1 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash



Fig. 2 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

NUMRI I KARTELAVE				
	2013	**2014**	**2015**	**15/14 (%)**
Kartela cash-i	754,380	813,026	862,779	6.1
Kartela pagese	754,380	799,742	862,580	7.8
- Debiti	645,048	678,090	718,717	6.0
- Krediti	109,332	121,652	143,863	18.2
Para elektronie	15,017	13,284	199	
Numri total (2+3)	769,397	813,026	862,779	6.1

Tab. 2 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

NUMRI I ATM DHE POS						
Terminalet	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**
ATM	**415**	**460**	**483**	**496**	**498**	**540**
Tërheqja kesh	415	460	483	496	498	540
Trans.kredi	141	147	145	148	50	97
Kos-Giro	39	69	73	70	50	97
Dep.cash	0	1	1	8	13	78
Terminale POS	**6,194**	**7,534**	**8,592**	**9,071**	**9,349**	**9,705**
Tërh.kesh	212	1,376	220	215	220	180
EFTPOS	5,930	6,320	8,499	8,856	9,179	9,360
Ter. virt. POS për kart.	**0**	**0**	**0**	**0**	**7**	**8**
Ter. për para elek.	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**	**0**

Tab. 3 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

NUMRI I TRANSAKSIONEVE ME KARTELA			
Përshkrimi	**2013**	**2014**	**2015**
Totali	13,129,074	14,734,189	16,183,996
- ATM tërheqje cash	9,251,512	9,926,136	10,422,617
- ATM depozitime	5,314	27,724	232,625
- Kredit trans. ATM-ve	108,308	70,160	42,572
- Tërheqje cash POS	21,964	13,333	14,523
- Pag. me kartela në POS	3,741,976	4,696,836	5,471,659

Tab. 4 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

VLERA DHE LLOJI I TRANSAKSIONEVE(MILIONË EURO)			
Përshkrimi	**2013**	**2014**	**2015**
Totali I trasaksioneve	1,155	1,262	1,728
ATM cash	936.2	996.3	1,222.70
ATM depozitime	1.9	13.5	181.4
ATM kredi transf.	1	0.5	0.4
POS tërheqje	24.6	13.9	20.3
POS pagesa	191.9	238.1	303.2

Tab. 5 | Burimi: BQK – Raporti mujor mbi instrumentet cash dhe jocash

III.
INDIKATORËT KRYESORË TË INDUSTRISË BANKARE

Struktura e aseteve

STRUKTURA E ASETEVE TË INDUSTRISË BANKARE (2010-2016) (milion euro)							
Përshkrimi	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**Sht-16**
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	331.5	425.7	463.3	447.1	491.2	418.9
Bilanci me bankat komerciale	439.1	329.5	287.9	339.9	390.8	316.0	339.1
Letrat me vlerë	173.4	202.0	256.6	354.5	383.8	473.3	479.5
Kreditë dhe lizingu	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.3	2,019.5	2,184.4
Asetet fikse	44.0	47.4	57.7	55.5	53.7	57.0	57.7
Asetet tjera	32.9	41.3	38.1	40.3	28.8	29.5	33.2
Gjithsej Asete	**2,455.1**	**2,649.7**	**2,829.3**	**3,059.3**	**3,186.6**	**3,385.3**	**3,512.7**

Tab. 6 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

PËRBËRJA E STRUKTURES SË ASETEVE TË INDUSTRISË BANKARE (2010 -2016) (milion euro)							
Përshkrimi	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**Sht-16**
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	12.5%	12.5%	15.0%	15.1%	14.0%	14.5%	11.9%
Bilanci me bankat komerciale	17.9%	12.4%	10.2%	11.1%	12.3%	9.3%	9.7%
Letrat me vlerë	7.1%	7.6%	9.1%	11.6%	12.0%	14.0%	13.6%
Kreditë dhe lizingu	59.4%	64.1%	62.3%	59.0%	59.1%	59.7%	62.2%
Asetet fikse	1.8%	1.8%	2.0%	1.8%	1.7%	1.7%	1.6%
Asetet tjera	1.3%	1.6%	1.3%	1.3%	0.9%	0.8%	0.9%
Gjithsej	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**

Tab. 7 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese



Fig. 3 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010 - 2016) (milion euro)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18.0	109.1	521.2	39.5	18.9	22.0	113.6	1,022.8
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	55.0	99.9	1,149.5
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	54.5	108.8	1,194.2
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	68.8	102.6	1,217.4
2014	49.8	19.7	153.0	20.3	107.0	674.5	51.4	18.1	60.6	102.0	1,256.4
2015	59.9	19.2	164.1	17.8	99.5	683.0	50.7	21.3	94.0	123.8	1,333.4
Sht-2016	58.6	27.1	166.1	19.6	102.2	692.9	45.7	21.3	101.4	145.7	1,380.6

Tab. 8 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik

PJESËMARRJA E KREDIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010-2016)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	3.7%	1.4%	12.5%	1.8%	10.7%	51.0%	3.9%	1.9%	2.2%	11.1%	100.0%
2011	3.5%	1.5%	11.9%	1.3%	10.1%	52.7%	3.5%	2.0%	4.8%	8.7%	100.0%
2012	3.7%	1.4%	11.1%	1.3%	10.5%	53.2%	3.2%	1.9%	4.6%	9.1%	100.0%
2013	3.8%	1.7%	10.8%	1.7%	9.8%	52.6%	4.0%	1.6%	5.6%	8.4%	100.0%
2014	4.0%	1.6%	12.2%	1.6%	8.5%	53.7%	4.1%	1.4%	4.8%	8.1%	100.0%
2015	4.5%	1.4%	12.3%	1.3%	7.5%	51.2%	3.8%	1.6%	7.1%	9.3%	100.0%
Sht-2016	4.2%	2.0%	12.0%	1.4%	7.4%	50.2%	3.3%	1.5%	7.3%	10.6%	100.0%

Tab. 9 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik

Struktura e detyrimeve

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRISË BANKARE (2010-2016) (milion euro)							
Përshkrimi	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**Sht-16**
Bilanci nga bankat tjera	70.7	40.0	6.0	16.5	32.2	43.4	73.2
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,702.9	2,789.5
Huatë tjera	23.4	30.4	18.9	13.4	14.1	17.6	18.7
Provizionet e shlyera	0.1	0.2	1.7	2.0	2.9	2.7	3.3
Detyrimet tjera	160.1	191.3	221.4	244.1	229.9	189.1	183.8
Borxhi i ndërvarur	33.5	31.0	31.0	56.3	47.2	36.9	37.4
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.5	0.1	-	-	-
Mjetet vetanake	230.4	252.8	270.7	277.8	323.1	392.7	406.8
Gjithsej Detyrime	**2,455.1**	**2,649.7**	**2,829.3**	**3,059.3**	**3,186.6**	**3,385.3**	**3,512.7**

Tab. 10 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

PJESËMARRJA E STRUKTURËS SË DETYRIMEVE TË INDUSTRISË BANKARE (2010-2016)							
Përshkrimi	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**Sht-16**
Bilanci nga bankat tjera	2.9%	1.5%	0.2%	0.5%	1.0%	1.3%	2.1%
Depozitat	78.9%	79.4%	80.6%	80.1%	79.6%	79.8%	79.4%
Huatë tjera	1.0%	1.1%	0.7%	0.4%	0.4%	0.5%	0.5%
Provizionet e shlyera	0.0%	0.0%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%
Detyrimet tjera	6.5%	7.2%	7.8%	8.0%	7.2%	5.6%	5.2%
Borxhi i ndërvarur	1.4%	1.2%	1.1%	1.8%	1.5%	1.1%	1.1%
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.0%	0.0%	-	-	-
Mjetet vetanake	9.4%	9.5%	9.6%	9.1%	10.1%	11.6%	11.6%
Gjithsej Detyrime	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**	**100.0%**

Tab. 11 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese



Fig.11 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

Të hyrat dhe shpenzimet

TË HYRAT E INDUSTRISË BANKARE (2010-2015) (milion euro)									
Periudha	**Të hyrat nga interesi**					**Të hyrat nga jo-interesi**		**Të hyrat nga rivlerë-simet**	**Totali**
	Gjithsej të hyra nga interesi	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera oper-ative		
2010	175.4	169.6	2.7	3.1	-	37.5	3.9	0.3	217.1
2011	194.6	186.3	4.1	4.2	-	41.7	3.3	0.0	239.6
2012	199.2	194.9	2.0	2.3	-	44.9	2.4	0.7	247.1
2013	198.2	192.5	1.4	2.3	2.0	45.6	3.9	1.2	249.0
2014	193.5	189.5	1.1	2.9	-	44.5	3.3	2.9	244.2
2015	186.0	180.4	0.5	4.4	0.7	47.1	4.0	1.1	238.2

Tab. 12 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese



Fig. 5 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

SHPENZIMET E INDUSTRISË BANKARE (2010-2015) (milion euro)											
Periudha	Shpenzimet e interesit				Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Gjithsej shpenz.e interesit	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizio-net për humbjet e kredive	Shp.per-sonelit	Shp.të përg-jithshme	Shp.tjera nga jo-in-teresi		
2010	55.2	49.4	4.8	1.0	7.7	28.3	37.8	37.6	12.6	5.0	184.3
2011	58.4	51.3	5.6	1.5	8.5	34.8	40.7	33.5	22.9	5.3	204.1
2012	63.1	57.6	3.2	2.3	8.7	50.3	42.3	35.5	24.5	4.0	228.6
2013	63.8	58.0	2.6	3.2	9.4	46.1	42.3	35.6	22.5	3.2	223.0
2014	44.0	36.4	3.1	4.5	11.1	20.5	42.4	34.8	24.5	6.8	184.2
2015	22.6	16.7	3.8	2.1	12.0	-8.4	44.0	35.7	27.8	9.7	143.5

Tab. 13 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese



Fig. 6 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese



Fig. 7 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

TË HYRAT E INDUSTRISË BANKARE (milion euro)									
Periudha	**Të hyrat nga interesi**					**Të hyrat nga jo-interesi**		**Të hyrat nga riv-lerësimet**	**Totali**
	Gjithsej të hyra nga interesi	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhu-rat tjera operative		
Sht-2015	140.8	136.5	0.5	3.2	0.6	34.7	2.9	0.9	**179.2**
Sht-2016	134.4	-	-	-	-	35.9	2.9	2.0	**175.2**

Tab. 14 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

SHPENZIMET E INDUSTRISË BANKARE (milion euro)											
Periudha	**Shpenzimet e interesit**				**Shpenzimet e jo-inter-esit**		**Shp.të përgjithshme dhe admin.**			**Provizioni për taksat**	**Totali**
	Gjithsej spenz. e interesit	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizio-net për humbjet e kredive	Shp.per-sonelit	Shp.të përg-jithshme	Shp.tjera nga jo-in-teresi		
Sht-2015	17.6	13.1	2.9	1.6	8.8	-	32.8	24.8	18.8	7.1	**109.9**
Sht-2016	13.7	-	-	-	12.1	9.1	31.0	32.2	9.0	6.8	**114.0**

Tab. 15 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese



Fig. 8 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

Normat efektive të interesit në kredi

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË KREDI (2010-2016)							
Përshkrimi	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**Sht-16**
Norma efektive në kredi të reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.49%
Norma efektive për korp.jofinanc.	14.11%	13.04%	12.34%	10.75%	9.56%	7.39%	6.90%
Norma efektive për ek.familjare	13.77%	13.85%	12.00%	11.33%	8.88%	8.39%	7.96%

Tab. 16 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar



Fig. 9 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar

Normat efektive të interesit në depozita

DIFERENCA NDËRMJET NORMAVE TË INTERESIT NË KREDI DHE DEPOZITA (2010-2016)							
Përshkrimi	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**Sht-16**
Norma efektive për gjithsej kreditë e reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.49%
Normat efektive për gjithsej depozitat e reja	3.38%	3.62%	3.72%	2.40%	1.11%	1.15%	0.96%
Diferenca	**10.59%**	**9.68%**	**8.52%**	**8.50%**	**8.18%**	**6.54%**	**6.53%**

Tab. 17 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar



Fig. 10 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar

Kreditë jo-performuese

KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2016)							
Përshkrimi	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**Sht-16**
Vlera e kredive jo-performuese	86.1	96.8	132.3	157.1	154.4	125.2	111.4
Provizionet për humbje nga kreditë	115.0%	116.7%	112.7%	110.5%	114.4%	115.1%	122.1%

Tab. 18 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore

KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2016)							
Përshkrimi	**2010**	**2011**	**2012**	**2013**	**2014**	**2015**	**Sht-16**
Kreditë jo-performuese (%)	5.9%	5.8%	7.5%	8.7%	8.3%	6.2%	5.1%
NPL rritja/zvogëlimi (%)	51.7%	12.5%	36.6%	18.8%	-1.7%	-18.9%	-11.0%
Përqindja e rritjes kreditore	13.2%	16.4%	3.8%	2.4%	4.2%	7.3%	8.2%

Tab. 19 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore



Fig. 11 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore

Referencat

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, tetor 2016, http://bqk-kos.org/?id=55;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti mujor mbi intrumentet cash dhe jocash, tetor 2016, http://bqk-kos.org/?id=125;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti vjetor 2013 dhe 2014, http://bqk-kos.org/?id=102;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti i informatave mujore të sistemit financiar, shtator 2015, http://bqk-kos.org/?id=98;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në kredi të reja, tetor 2016, http://bqk-kos.org/?id=55;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në depozita të reja, tetor 2016, http://bqk-kos.org/?id=55;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese, tetor 2016, http://bqk-kos.org/?id=55;

PJESA IV
LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE DHE EKONOMIA QË SHËNUAN MUAJIN TETOR

RAIFFEISEN DHURON PAJISJE PËR SPITALET RAJONALE NË VLERË PREJ 50,000 EURO

Gjatë këtij viti, Banka Raiffeisen ka dhuruar pajisje për repartet e gjinekologjisë të 6 Spitaleve të Përgjithshme në Kosovë në vlerë prej 50 000 eurove. Para dy viteve, ndërkaq, ka dhuruar donacion në QKUK në vlerë prej 100 000 euro, gjithashtu për Klinikën e Gjinekologjisë.

Ministri i Shëndetësisë Imet Rrahmani priti sot drejtorin ekzekutiv të Bankës Raiffeisen në Kosovë Robert Wright, me të cilin biseduan për bashkëpunimin dhe përkrahjen që kjo bankë me donacione është duke i dhënë sektorit të shëndetësisë në Kosovë. Drejtori ekzekutiv i Bankës Raiffeisen, Robert Wright , tha se është i lumtur që kjo bankë ka pasur mundësinë që të ndihmojë institucionet shëndetësore dhe pacientët përmes sigurimit të pajisjeve të ndryshme, të cilat ai vlerësoi se po përdoren drejt me qëllim të përmirësimit të shërbimeve shëndetësore në Kosovë. Në këtë aspekt, z. Wright tha se është i kënaqur edhe me bashkëpunimin me MSh-në dhe institucionet shëndetësore që donacionet të japin efektin për çka është kontribuar. (Zëri, 7 tetor 2016).

QEVERIA E KOSOVËS KA MBAJTUR ANKANDIN E RADHËS TË BONOVE TË THESARIT

Qeveria e Republikës së Kosovës ka mbajtur Ankandin e radhës të Bonove të Thesarit KV016- 16 i cili u mbajt më 11 tetor 2016, ku u ofertuan Bono Thesari me maturitet 3 mujor në vlerë nominale 10 milionë euro. Shuma e ngritur në këtë ankand do të shërbej për ri financimin e Bonove 3 mujore të emetuara paraprakisht. "Në këtë ankand të Bonove të Thesarit, tregu shfaqi kërkesë për blerje në vlerë 26.30 milionë euro, kurse ne pranuam vetëm shumën e shpallur paraprakisht e që është 10 milionë Euro.

Norma e interesit për këtë ankand ishte 0.09% vjetore. Kërkesat e larta për blerje të Bonove të Thesarit tregojnë besueshmërinë dhe qëndrueshmërinë buxhetore dhe financiare në Kosovë", është thënë në komunikatën për media të Ministrisë së Financave. (RTK Live, 13 tetor 2016).

PËR 9 MUAJ, 28 RASTE TË KRIMEVE KIBERNETIKE NË KOSOVË

Që nga janari e deri në muajin shtator në Sektorin për Hetimin e Krimeve Kibernetike në Policinë e Kosovës janë hapur 28 raste të ndryshme të krimeve kibernetike, ndërsa janë kryer 138 asistenca në të gjitha regjionet policore të Kosovës, si dhe jashtë Republikës së Kosovës. Sipas Ministrisë së Punëve të Brendshme, 22 raste ndërlidhen me nenin 339 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës 'Hyrje në sistemet kompjuterike', e të cilat kryesisht kanë të bëjnë me mashtrime të kompanive duke bërë ndërhyrje në e-mail adresat e tyre, shkruan sot Koha Ditore. "Përmes veprimeve të caktuara është bërë ndërrimi i xhirollogarisë bankare të bizneseve nga ajo reale në atë të falsifikuar, dhe për pasojë disa biznese janë dëmtuar në shuma të mëdha të parave, 4 raste ndërlidhen me nenin 238 'Keqpërdorimi i fëmijëve në pornografi', 2 raste ndërlidhen me nenin 307 'Lëshimi i çeqeve pa mbulesë ose të rremë dhe keqpërdorimi i kartelave të bankës apo të kreditit (vendosja e pajisjeve të modifikuara në bankomatët (ATM) e bankave në Republikën e Kosovës për klonimin-kopjimin e kredit-kartave bankare", thuhet në përgjigjen e Ministrisë së Punëve të Brendshme. (Koha Ditore, 17 tetor 2016).

KREDITË E KËQIJA ULEN NË 5.3 PËR QIND

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK), ka njoftuar se norma e kredive joperformuese ka vazhduar të zvogëlohet edhe gjatë tremujorit të dytë, duke zbritur në 5.3 përqind në qershor 2016. "Përderisa edhe treguesit tjerë të shëndetit financiar vazhduan të kenë gjendje të kënaqshme", është thënë në raportin e BQK-së, për 'Vlerësimin tremujor të ekonomisë', raporton "Rtklive". Sipas BQK-së norma mesatare e interesit në kredi zbriti në 7.2 përqind, duke nxitur kështu kërkesën për kredi si nga ndërmarrjet ashtu dhe nga ekonomitë familjare. "Ndërsa, norma mesatare e interesit në depozita ka shënuar një ngritje të lehtë duke arritur në 1.0 për qind", është thënë në raport. (Zëri, Epoka e Re, 18 tetor 2016).

KOSOVA E 60-TA PËR BIZNES

Raporti i Bankës Botërore "Të Bërit Biznes 2017" i publikuar mbrëmë, konfirmon progresin e arritur nga Kosova në përmirësimin e mjedisit afarist, duke ngritur rangimin e saj botëror në vendin e 60-të nga vendi i 64 sa është ranguar me revidimin e raportit të mëparshëm. Kështu u tha në konferencën për medie në të cilën u shpalosen hollësitë e raportit të BB nga kryeministri Isa Mustafa dhe ministrja e MTI, Hykmete Bajrami. Kryeministri i Kosovës Isa Mustafa vlerësoi lart raportin e Bankës Botërore për Kosovën. Ai tha se objektiv kryesor i Qeverisë është zhvillimi ekonomik dhe krijimi i vendeve të reja të punës. (Telegrafi, 27 tetor 2016).

BPB FITON DY ÇMIME EKSKLUZIVE

BPB fiton çmimin si "Banka Komerciale me Rritje më të Shpejtë" dhe "Banka me Përgjegjësi Sociale më të mirë në Kosovë" për vitin 2016. Çmimet janë dhënë nga organizata prestigjioze Global Banking and Finance (GBAF), e cila është ndër publikuesit kryesor në botë e specializuar në shqyrtimin e performancës bankare dhe lexohet në mbi 200 vende të ndryshme. Arton Celina, kryeshefi ekzekutiv i BPB, tha: 'Jemi një bankë vendore që synon një rritje të përgjegjshme dhe stabile dhe këto dy çmime tregojnë se jemi në rrugë të drejtë. Falenderim i veçantë për të gjithë ata që kanë bërë këto dy cmime të mundshme, e që janë klientët tonë me besimin e tyre tek ne dhe personeli me punën e tyre të palodhshme. (Kosova Press, 19 tetor 2016).

EDUKIM FINANCIAR PËR VENDIME TË DUHURA

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës në bashkëpunim me Ambasadën Amerikane, në kuadër të edukimit financiar kanë organizuar sot aktivitetin e radhës me nxënës të shkollave të mesme të kryeqytetit, me moton "Edukim financiar për vendime të duhura". Dhjetëra nxënësve të mbledhur në Amfiteatrin e Bibliotekës Kombëtare, zyrtarë të BQK-së dhe të Ambasadës iu kanë folur rreth rëndësisë që ka edukimi financiar, menaxhimi i mirë i parasë etj. Atyre iu është shpërndarë dhe një broshurë e përgatitur nga Departamenti për Marrëdhënie me jashtë, në kuadër të BQK-së, ku gjenden informata rreth Rolit të Bankës Qendrore të Kosovës në ekonominë e vendit, politikës monetare të Kosovës, letrave me vlerë, sistemittë pagesave, licencimit të institucioneve financiare, strukturës se sektorit financiar dhe tema tjera rreth fushës se ekonomisë dhe financave. Këta nxënës, më 31 tetor, pikërisht në Ditën Ndërkombëtare të Kursimeve, do t'i shpalosin njohuritë e fituara në kuizin që do të mbahet në kuadër të këtij projekti."Të marrësh njohuri dhe të zhvillosh aftësitë që të kesh kulturë financiare është vërtet një sfidë. Por ju do të përftoni nga këto shkathtësi përgjatë tërë jetës", iu tha nxënësve Meredith Rubin, zyrtare e lartë ekonomike nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Kosovë. (RTK Live, 19 tetor 2016).

PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

"Periodiku Bankar" është botim mujor i Shoqatës së Bankave të Kosovës duke filluar me publikimin e parë në muajin janar të vitit 2014. Publikimet mujore përmbajnë të dhëna dhe vlerësime të përgjithshme mbi sistemin financiar në Kosovë. Çdo publikim mujor trajton çështje të caktuara të sistemit financiar që për vëmendje kryesore ka sektorin bankar në Kosovë.
www.bankassoc-kos.com.

Qendra për Trajnime Bankare

TRAJNIMET PËR VITIN 2016:

- Certifikimi Ndërkombëtar EFCB
- Bazat e Pajtueshmërisë
- Lidershipi dhe formimi i Ekipeve
- Menaxhimi i Riskut Operacional
- Menaxhimi i Porfolios së Riskut Kreditor
- IFRS
- Nga Zyrtar i TI në Auditor të TI
- Menaxhimi i Riskut të Kredisë dhe Tregut
- Trajnimi i Trajnerëve

Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Qendrën për Trajnime Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

038 246 171
kbtraining@bankassoc-kos.com

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS
KOSOVO BANKING ASSOCIATION